



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.830 /2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Nenad Lazic dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës në koalicion me Lidhja Demokratike e Dardanisë (AAK-LDD), dega në Junik paraqitur kundër Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), dega në Junik për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 12.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës në koalicion me Lidhja Demokratike e Dardanisë (AAK-LDD), dega në Junik.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 12.11.2013, nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës në koalicion me Lidhja Demokratike e Dardanisë (AAK-LDD), dega në Junik në të cilën ka pretenduar se në Qendrën e Vendvotimit (QV), 3101C/06R ka pasur falsifikim të rezultatit zgjedhor, shtimi i votave për subjektin e tyre nga komisionerët e tyre, pengimi i procesit zgjedhor dhe manipulimi i rezultatit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 LZP-së, parashihet se: *“Mund te apeloohen vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullores së PZAP-I lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 830/2013 më datën 12.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.